Raport krahasimor për vlerësimin institucional me nxënësit, mësuesit, prindërit dhe bizneset

Shkolla Profesionale “Tregtare” Vlorë

Viti shkollor 2025 - 2026

Shtator 2026

Tabela e përmbajtjes

Lista e Tabelave 3
Hyrje 7
Metodologjia 7
Të dhëna për pjesëmarrësit 2026 9
Rezultatet 10
Zhvillimi i vazhduar profesional 10
Kurrikula 11
Marrëdhënia me biznesit 11
Orientimi në karrierë 12
Projektet 13
Marketingu 14
Gjurmimi në nivel ofruesi 15

Lista e Tabelave

Tabela 1: Numri i pyetësorëve të plotësuar për secilin target grup 9
Tabela 2: Rezultatet për treguesit e zhvillimit të vazhduar profesional 10
Tabela 3: Rezultatet për treguesit e kurrikulës 11
Tabela 4: Rezultatet për treguesit e marrëdhënieve me biznesin 12
Tabela 5: Rezultatet për treguesit e orientimit në karrierë 12
Tabela 6: Rezultatet për treguesit e projekteve 13
Tabela 7: Rezultatet për treguesit e marketingut 14
Tabela 8: Rezultatet për treguesit e gjurmimit në nivel ofruesi 15

© 2026 Swisscontact

Rreth projektit "Aftësi për Punë" (S4J)

Aftësi për Punë (S4J) është një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) i zbatuar nga Sëisscontact, i cili synon të adresojë sfidat kryesore në Arsimin dhe Formimin Profesional (AFP) në Shqipëri. Që prej tetorit 2015, projekti "Aftësi për Punë" (S4J) mbështet qeverinë dhe aktorët e tjerë të interesit për të ndërtuar një sistem cilësor të AFP në Shqipëri, i frymëzuar nga modeli zviceran. Në fazën e tij të tretë (2024-2027), me theks të veçantë tek qëndrueshmëria, projekti është angazhuar në ndarjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të njohurive dhe përvojave të përftuara në nivel sistemi, në bashkëpunim të ngushtë me shkollat partnere.

Përmbledhje ekzekutive

Vlerësimi institucional 2025–2026 në Shkollën Profesionale "Tregtare" Vlorë mbështetet në përgjigjet e 193 nxënësve, 10 mësuesve, 71 prindërve dhe 33 bizneseve, dhe është cikli i tretë i matjes. Numri i mësuesve pjesëmarrës ra ndjeshëm (nga 25 në 2025 në 10 në 2026). Me 10 përgjigje, çdo mësues përfaqëson 10 p.p., prandaj ndryshimet te treguesit e mësuesve duhen konfirmuar para se të interpretohen si prirje.

Pikat e forta

- Bizneset partnere e vlerësojnë shumë lart shkollën: 97.0% janë të kënaqura me përgatitjen e nxënësve, 100% mendojnë se shkolla u plotëson nevojat për aftësi cilësore pune dhe 100% e vlerësojnë si institucion me reputacion të mirë; 93.8% raportojnë bashkëpunim të ngushtë.
- Pjesëmarrja e nxënësve në praktikë profesionale në biznes u rikuperua në 93.2% (nga 73.4% në 2025).
- Orientimi në karrierë shënon përmirësim: 93.4% e nxënësve kanë marrë shërbime, informimi për mundësitë e punësimit u rrit në 78.6%, dhe besimi i prindërve se orientimi ndihmon vendimmarrjen e fëmijës u rrit për të tretin vit radhazi (69.1% → 76.4% → 88.4%).
- Përdorimi i të dhënave të gjurmimit nga drejtuesit dhe mësuesit për procesin mësimor u rrit në 90.0% (nga 68.0%).

Fushat që kërkojnë vëmendje

- Treguesit e mësuesve për ZHVP-në, mbështetjen e koordinatorit të kurrikulës dhe projektet ranë në 2026 (p.sh. përputhja e ZHVP-së me nevojat 80.0% → 60.0%; kënaqësia me mbështetjen e koordinatorit të kurrikulës 88.0% → 60.0%; përfshirja në hartimin e projekteve 60.0% → 30.0%). Duke pasur parasysh bazën e vogël, këto rezultate duhen diskutuar me stafin për të kuptuar nëse pasqyrojnë një ndryshim real.
- Megjithëse më shumë nxënës bëjnë praktikë, kënaqësia e tyre me mundësitë e praktikës (89.9% → 77.4%) dhe me realizimin e saj sipas planit (89.9% → 74.1%) ra.
- Nxënësit e vlerësojnë ndjeshëm më ulët cilësinë e informacionit në materialet e marketingut (88.6% → 60.1%), ndërsa vlerësimi i prindërve për imazhin e shkollës ra (86.9% → 69.9%).
- Vetëm 37.5% e bizneseve deklarohen të kënaqura me bashkëpunimin (62.5% neutrale), rezultat që nuk përputhet me vlerësimet shumë pozitive të tyre në treguesit e tjerë dhe që kërkon verifikim para interpretimit.

Lidhjet ndërmjet funksioneve

- Bizneset i vlerësojnë shumë lart nxënësit, ndërsa vetë nxënësit janë më pak të kënaqur me organizimin e praktikës. Zgjerimi i praktikës duket se kërkon tani vëmendje ndaj cilësisë së planifikimit dhe ndjekjes së saj, duke dëgjuar më drejtpërdrejt përvojën e nxënësve.

– Rënia e njëkohshme e treguesve të mësuesve në ZHVP, kurrikul dhe projekte mund të lidhet me ndryshimin e numrit dhe të përbërjes së mësuesve që u përgjigjën (10 kundrejt 25), jo domosdoshmërisht me ndryshim në cilësinë e shërbimeve.

Mbi bazën e këtyre gjetjeve, raporti përfundon me pesë rekomandime për forcimin institucional (shih seksionin “Rekomandime për forcimin institucional”).

Shënim: Ndryshimet ndërmjet viteve shprehen në pikë përqindjeje (p.p.). Lidhjet ndërmjet funksioneve paraqiten si modele të vëzhguara në të dhëna, jo si marrëdhënie shkak-pasojë.

Hyrje

Ky raport paraqet gjetjet nga procesi i **Vlerësimit Institucional** të zhvilluar në Shkollën **"Tregtare"** Vlorë për vitin shkollor 2025 -2026. Procesi, me synim vlerësimin e cilësisë së shërbimeve të aftësimit profesional, përfshiu nxënës, mësues, prindër dhe biznese partnere, të cilët u anketuan gjatë periudhës maj-qershor 2025. Ky vit shënon realizimin e procesit për të tretin vit radhazi, duke e konsoliduar si një praktikë të qëndrueshme dhe të rëndësishme për përmirësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve.

Procesi u koordinua nga Njësia e Zhvillimit (NjZH) në shkollë, e cila luan një rol kyç në monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimeve. Përshkrimi i gjetjeve në raport është i organizuar sipas treguesve për secilin funksion të NJZH-së.

Ky proces vlerësues mbështetet në përvojën e vitit shkollor 2023 - 2025, ku projekti 'Aftësi për Punë' (S4J), në bashkëpunim me gjashtë shkolla partnere[1], zhvilloi katër instrumente vlerësimi (pyetësorë), të bazuar në një metodologji rigoroze dhe pjesëmarrëse. Pas pilotimit në gjashtë shkolla, instrumentet u rishikuan për të garantuar vlefshmëri, qëndrueshmëri dhe respektim të standardeve etike[2].

Metodologjia

Në kuadër të mbledhjes së informacionit që do të ushqejë analizën vjetore të performancës institucionale, në përfundim të çdo viti shkollor do të realizohet një proces vlerësimi institucional në nivel ofruesi duke përfshirë katër grupeve kryesore: nxënës, mësues, biznese dhe prindër. Ky proces synon të vlerësojë performancën institucionale, të identifikojë fushat për përmirësim dhe të informojë objektivat e planit vjetor të institucionit.

Për këtë qëllim, janë zhvilluar katër instrumente vlerësimi (pyetësor), si vijon:

Pyetësori për nxënësit synon të mbledh mendimet dhe përvojat e nxënësve për cilësinë e shërbimeve të aftësimit profesional. Fokusohet në cilësinë e mësimdhënies, praktikën profesionale, orientimin në karrierë dhe performancën e institucionit. Qëllimi është përmirësimi i programeve për të përgatitur më mirë nxënësit për tregun e punës.

Pyetësori për mësuesit synon të mbledh mendimet dhe përvojat e mësuesve për cilësinë e shërbimeve të aftësimit profesional dhe mjedisit të të nxënit. Fokusohet në zhvillimin profesional, zbërthimin e kurrikulës, projektet zhvillimore dhe dhe performancën e institucionit. Qëllimi është identifikimi i fushave për përmirësim dhe përshtatja e praktikave me nevojat e stafit dhe nxënësve.

Pyetësori për bizneset synon të mbledh perceptimet e bizneseve për cilësinë e bashkëpunimit me institucionin dhe përvojën me nxënësit gjatë praktikës profesionale. Fokusohet

[1] Hamdi Bushati, Kolin Gjoka, Kristo Isak, Shkolla Profesionale Elbasan, Shkolla Teknike Ekonomike Tirane, Tregtare.
[2] Për më shumë informacion, shih raportin Baseline i treguesve të cilësisë së Njësisë së Zhvillimit https://skillsforjobs.al/publications/baseline-i-treguesve-te-cilesise-se-njesise-se-zhvillimit/

në përgatitjen e nxënësve, përputhshmërinë e programeve të praktikës me nevojat e tregut të punës dhe mundësitë për përmirësim. Qëllimi është forcimi i bashkëpunimit dhe angazhimi cilësor i sektorit privat në proceset e aftësimit profesional.

Pyetësori për prindërit synon të mbledhë mendimet e prindërve për cilësinë e shërbimeve të aftësimit profesional. Fokusohet në komunikimin me shkollën, orientimin në karrierë të fëmijëve dhe imazhin e institucionit. Qëllimi është përmirësimi i shërbimeve për të përmbushur pritshmëritë dhe nevojat e nxënësve dhe prindërve.

Të dhëna për pjesëmarrësit 2026

Për vitin shkollor 2025-2026, në shkollën profesionale "Tregtare" 193 nxënës morën pjesë në sondazh. Nga këta, 62.2% (N=120) ishin djem dhe 37.3% (N=72) ishin vajza. Të shpërndarë sipas klasave, 21.9% (N=42) e të anketuarve janë në klasën e dhjetë, 29.2% (N=56) në klasën e njëmbëdhjetë, 26% (N=50) në klasën e dymbëdhjetë, 22.4% (N=43) në klasën e trembëdhjetë dhe 0.5% (N=1) arsim profesional pas të mesëm.

Ndërkohë, morën pjesë në anketim 10 mësues, nga ku 80.0% (N=8) janë femra dhe 20% (N=2) janë meshkuj. Të ndarë sipas grup lëndëve që japin mësim 10% (N=1) japin lëndë të teorisë profesionale, dhe 90% (N=9) japin njëkohësisht lëndë të teorisë profesionale.

Në sondazhin për bizneset partnere të shkollës kanë marrë pjesë 33 biznese, nga ku 27.4% (N=12) janë të kënaqur më bashkëpunimin me shkollën ndërsa 62.5% (N=21) janë neutral për cilësinë e bashkëpunimit. Por 100% e tyre shprehen se kanë modalitete të ndryshme bashkëpunimi me të.

Për vitin shkollor 2025-2026 në shkollën profesionale "Tregtare" janë anketuar 71 prindër. Nga këta 27.4% (N=20) ishin meshkuj dhe 69.9% (N=51) ishin femra. Të shpërndarë sipas klasën që ndjek fëmija, 34.7% (N=25) kanë pohuar se fëmija e tyre ndjek klasën e dhjetë, 20.8% (N=15) klasën e njëmbëdhjetë, 25% (N=18) në klasën e dymbëdhjetë dhe 19.4% (N=14) në klasën e trembëdhjetë.

Tabela 1: Numri i pyetësorëve të plotësuar për secilin target grup

Përfituesit	**2024**	**2025**	**2026**
Nxënës	184	232	193
Mësues	18	25	10
Prindër	150	153	71
Biznese	70	85	33

Rezultatet

Seksionet më poshtë përmbledhin rezultatet e matjeve me nxënësit, mësuesit, prindërit dhe bizneset. Ndërkohë, listën e plotë të gjetjeve për cdo pyetësor e gjeni në Shtojcën 1.

Zhvillimi i vazhduar profesional

Krahasimi i rezultateve për vitet 2025 dhe 2026 tregon një trend të përzier, me rënie në disa tregues të lidhur me përvojën e mësuesve, ndërsa disa tregues të tjerë paraqesin përmirësim. Tek mësuesit, përputhshmëria e aktiviteteve të ZHVP-së me nevojat e tyre ka rënë nga 80% në 2025 në 60% në 2026. Po ashtu, vlerësimi për përmirësimin e aftësive si rezultat i trajnimeve ka shënuar një rënie nga 91.7% në 80%. Rënia më e theksuar vërehet në kënaqësinë me mbështetjen gjatë zbatimit të planit të ZHVP-së, e cila ka kaluar nga 91.7% në 60%. Në të kundërt, aplikimi i njohurive, aftësive dhe metodave të reja në mësimdhënie ka shënuar një rritje të lehtë, nga 86.4% në 2025 në 88.9% në 2026, duke treguar një trend më të qëndrueshëm pozitiv në zbatimin praktik të përfitimeve nga trajnimet.

Tek nxënësit, rezultatet paraqesin gjithashtu një tendencë të ndryshme sipas treguesve. Kënaqësia me metodat e mësimdhënies ka rënë nga 81% në 2025 në 68.9% në 2026, ndërsa kënaqësia me metodat e përdorura gjatë procesit të mësimdhënies është rritur nga 66.2% në 76.7%. Ndërkohë, kënaqësia me shpeshtësinë e ndërveprimit ka shënuar një rënie të lehtë, nga 78.4% në 75.7%, por mbetet në një nivel relativisht të lartë.

Tabela 2: Rezultatet për treguesit e zhvillimit të vazhduar profesional

Përfitues të shërbimit	Treguesit e cilësisë	Rezultati 2024 %	Rezultati 2025 %	Rezultati 2026 %
Mësuesit e kulturës profesionale – përfitues direkt	1. Aktivitetet e ZHVP janë në përputhje me nevojat e mësuesve.	44.4	80.0	60.0
	2. Aftësitë e mësuesve janë përmirësuar nga trajnimet/aktivitetet e parashikuara në planin e ZHVP.	72.2	91.7	80.0
	3. Mësuesit janë të kënaqur me mbështetjen që kanë marrë gjatë zbatimit të planit të ZHVP.	83.3	91.7	60.0
	4. Mësuesit aplikojnë në mësimdhënie njohuritë aftësitë, shprehitë dhe metodat e reja të mësimdhënies që kanë mësuar në trajnime dhe shkëmbime.	85.7	86.4	88.9
Nxënësit – përfitues indirekt	1. Nxënësit janë të kënaqur me metodat e mësimdhënies (si p.sh., puna në grup, puna me projekte, përdorimi i teknologjisë, ndërveprimi në klasë etj.).	68.5	81.0	68.9
	2. Nxënësit janë të kënaqur me metodat e përdorura gjatë procesit të mësimdhënies.		66.2	76.7
	3. Nxënësit janë të kënaqur me shpeshtësinë e ndërveprimit gjatë procesit mësimor.	57.2	78.4	75.7

Kurrikula

Krahasimi i viteve 2025 dhe 2026 tregon një trend të ndryshëm sipas përfituesve. Tek mësuesit, lehtësia në zbërthimin e kurrikulës në përputhje me nevojat e tregut rajonal ka rënë nga 87.5% në 80%, ndërsa kënaqësia me mbështetjen e koordinatorit nga 88% në 60%. Tek nxënësit, perceptimi se programi mësimor është i përshtatur me tregun e punës ka mbetur pothuajse i pandryshuar, nga 87.7% në 87%. Edhe bizneset kanë shënuar një rënie të lehtë në vlerësimet e tyre, me kënaqësinë për njohuritë dhe aftësitë e nxënësve që ka kaluar nga 98.8% në 97%, ndërsa përshtatja e planeve të praktikës profesionale me nevojat e tyre nga 98.8% në 93.8%.

Tabela 3: Rezultatet për treguesit e kurrikulës

Përfitues të shërbimit	Treguesit e cilësisë	Rezultati 2024 %	Rezultati 2025 %	Rezultati 2026 %
Mësuesit – përfitues direkt	1. Mësuesit e kanë më të lehtë zbërthimin e kurrikulës në përputhet me nevojat rajonale të tregut të punës.	77.8	87.5	80.0
	2. Mësuesit janë të kënaqur me mbështetjen që kanë marrë nga koordinatori i kurrikulës për zbatimin e mësimdhënies	77.8	88.0	60.0
Nxënësit – përfitues indirekt	1. Nxënësit mendojnë se programi mësimor është e përshtatur me tregun e punës.	80.9	87.7	87.0
Bizneset – përfitues indirekt	1. Bizneset janë të kënaqur me njohuritë, aftësitë dhe shprehitë që kanë marrë nxënësit në shkollë.	82.4	98.8	97.0
	2. Bizneset mendojnë se planet e praktikës profesionale janë në përshtatje me nevojat e tyre.	84.3	98.8	93.8

Marrëdhënia me biznesit

Krahasimi i viteve 2025 dhe 2026 tregon një trend të ndryshëm midis nxënësve dhe bizneseve. Tek nxënësit, pjesëmarrja në praktikë profesionale është rritur ndjeshëm nga 73.4% në 93.2%, ndërsa kënaqësia si me mundësitë e ofruara nga shkolla, ashtu edhe me realizimin e praktikës sipas planit, ka rënë nga 89.9% në përkatësisht 77.4% dhe 74.1%. Tek bizneset, treguesit kanë mbetur përgjithësisht në nivele të larta: bashkëpunimi në forma të ndryshme dhe përmbushja e nevojave për aftësi cilësore pune kanë ruajtur nivelin 100%, ndërsa bashkëpunimi i ngushtë është rritur nga 92.9% në 93.8%. Në të kundërt, kënaqësia me bashkëpunimin me shkollën ka rënë lehtë nga 39% në 37.5%, ndërsa kënaqësia me cilësinë e përgatitjes së nxënësve nga 98.8% në 97%. Njohja e programit mësimor ka mbetur në 100%, ndërsa njohja e moduleve profesionale ka rënë lehtë nga 100% në 97%.

Tabela 4: Rezultatet për treguesit e marrëdhënieve me biznesin

Përfitues të shërbimit	Treguesit e cilësisë	Rezultati 2024 %	Rezultati 2025 %	Rezultati 2026 %
Nxënësit – përfitues direkt	1. % e nxënësve që kanë bërë praktikë profesionale në biznes.	93.5	73.4	93.2
	2. Niveli i kënaqësisë së nxënësve me mundësitë që ofron shkolla për praktikë profesionale në biznes.	83.0	89.9	77.4
	3. Niveli i kënaqësisë së nxënësve me realizimin e praktikës profesionale në biznes sipas planit të praktikës.	82.8	89.9	74.1
Bizneset – përfitues direkt	1. Bizneset bashkëpunojnë në forma të ndryshme me shkollën.	88.6	100	100.0
	2. Bizneset janë të kënaqura për bashkëpunimin me shkollën.	84.8	39.0	37.5
	3. Bizneset bashkëpunojnë ngushtë me shkollën.	44.9	92.9	93.8
	4. Bizneset janë të kënaqur me cilësinë e përgatitjes së nxënësve nga shkolla.	85.7	98.8	97.0
	5. Bizneset mendojnë se shkolla përmbush nevojat e biznesit për aftësi cilësore pune.	79.7	100	100.0
	6. Biznesi njeh programin mësimor që ofron shkolla.	68.6	100	100.0
	7. Biznesi njeh shumë mirë modulet profesionale qe ofron shkolla.	72.5	100	97.0

Orientimi në karrierë

Krahasimi i viteve 2025 dhe 2026 tregon një përmirësim të përgjithshëm në perceptimin e nxënësve dhe prindërve. Tek nxënësit, pjesëmarrja në shërbimet për orientim në karrierë është rritur nga 88.6% në 93.4%, ndërsa kënaqësia me cilësinë e sesioneve ka shënuar një rritje më të moderuar nga 89.7% në 85%. Në të njëjtën kohë, informimi për shanset e punësimit pas diplomimit është përmirësuar nga 69.5% në 78.6%. Tek prindërit, të dy treguesit kanë shënuar rritje, me kënaqësinë me shërbimin e orientimit që është rritur nga 65.4% në 82.4%, ndërsa besimi se orientimi ka ndihmuar fëmijën në marrjen e vendimeve për karrierën nga 76.4% në 88.4%.

Tabela 5: Rezultatet për treguesit e orientimit në karrierë

Përfitues të shërbimit	Treguesit e cilësisë	Rezultati 2024 %	Rezultati 2025 %	Rezultati 2026 %
Nxënësit – përfitues direkt	1. Nxënësit kanë marrë shërbime të ndryshme për orientimin në karrierë.	79.3	88.6	93.4

	2. Nxënësit janë të kënaqur me cilësinë e shërbimit të ofruar në sesionet e orientimit në karrierë.	76.1	89.7	85.0
	3. Nxënësit janë të informuar për shanset e punësimit pas diplomimit në profilin që po studiojnë.	74.0	69.5	78.6
Prindërit – përfitues indirekt	1. Prindërit janë të kënaqur me shërbimin për orientim në karrierë që i jep shkolla fëmijës.	78.5	65.4	82.4
	2. Prindërit besojnë se orientimi në karrierë e ka ndihmuar fëmijën për të marrë vendimet e duhura për karrierën.	69.1	76.4	88.4

Projektet

Krahasimi i viteve 2025 dhe 2026 tregon një rënie në disa prej treguesve të lidhur me projektet zhvillimore, veçanërisht tek mësuesit. Tek mësuesit, njohja e projekteve ka rënë nga 88% në 60%, ndërsa perceptimi se projektet përmirësojnë cilësinë e arsimit nga 76% në 60%. Përfshirja në shkrimin e projekteve ka shënuar një rënie më të theksuar, nga 60% në 30%, ndërsa përfshirja në zbatimin e tyre ka mbetur pothuajse e pandryshuar (56% në 2025). Tek nxënësit, njohja e projekteve ka rënë nga 89.2% në 78.8%, ndërsa përfshirja nga 79.4% në 70.1%. Në të kundërt, kënaqësia me përfshirjen në aktivitete ka mbetur e pandryshuar në 78%, ndërsa kënaqësia me rezultatet e projekteve është rritur nga 78.7% në 82%.

Tabela 6: Rezultatet për treguesit e projekteve

Përfitues të shërbimit	Treguesit e cilësisë	Rezultati 2024 %	Rezultati 2025 %	Rezultati 2026 %
Mësuesit – përfitues direkt	1. Mësuesit i njohin projektet zhvillimore të shkollës	55.6	88.0	60.0
	2. Mësuesit mendojnë se projektet zhvillimore të shkollës përmirësojnë cilësinë e arsimit	44.4	76.0	60.0
	3. Mësuesit janë të përfshirë në shkrimin e projekteve zhvillimore si pjesë e grupeve të punës	55.6	60.0	30.0
	4. Mësuesit janë të përfshirë zbatimin e projekteve zhvillimore.	55.6	56.0	
Nxënësit – përfitues direkt	1. Nxënësit janë të dijeni të projekteve zhvillimore në shkollë.	46.4	89.2	78.8
	2. Nxënësit janë të përfshirë në projekte zhvillimore	14.1	79.4	70.1
	3. Nxënësit janë të kënaqur me përfshirjen në aktivitete të	70.4	78.0	78.0

	projekteve të zhvilluara nga shkolla.			
	4. Nxënësit janë të kënaqur me rezultatet e projekteve të zbatuara nga shkolla.	79.4	78.7	82.0

Marketingu

Për vitet 2025–2026, krahasimi tregon një rënie të përgjithshme në perceptimin mbi marketingun e shkollës, me përjashtim të vlerësimit nga bizneset. Tek mësuesit, kënaqësia me aktivitetet e marketingut ka rënë nga 84% në 80%, ndërsa cilësia e materialeve informuese nga 92% në 77.8%. Edhe perceptimi për imazhin e shkollës ka rënë nga 96% në 80%, ndërsa ndjenja e përfshirjes ka zbritur nga 60% në 50%. Tek nxënësit, të gjithë treguesit kanë shënuar rënie, ku më e theksuar është ajo në vlerësimin e cilësisë së materialeve, nga 88.6% në 60.1%. Ndërkohë, bizneset kanë ruajtur vlerësimin maksimal prej 100%, ndërsa tek prindërit vërehet një rënie nga 86.9% në 69.9%.

Tabela 7: Rezultatet për treguesit e marketingut

Përfitues të shërbimit	Treguesit e cilësisë	Rezultati 2024 %	Rezultati 2025 %	Rezultati 2026 %
Mësuesit – përfitues indirekt	1. Mësuesit janë të kënaqur me aktivitetet e planit të marketingut të shkollës.	66.7	84.0	80.0
	2. Mësuesit mendojnë se materialet informuese për marketingun janë cilësore	93.3	92.0	77.8
	3. Mësuesit janë të kënaqur me imazhi që ka shkollë	66.7	96.0	80.0
	4. Mësuesit ndihen të përfshirë në aktivitetet e marketingut të shkollës.	64.7	60.0	50.0
Nxënësit – përfitues indirekt	1. Nxënësit janë të kënaqur me aktivitetet e marketingut të shkollës	53.3	79.7	77.0
	2. Nxënësit mendojnë se informacioni i dhënë në materialet e marketingut është cilësor.	75.0	88.6	60.1
	3. Nxënësit janë të kënaqur me imazhit të shkollës.	61.1	83.1	74.6
	4. Nxënësit ndihen të përfshirë në aktivitetet e marketingut.	20.9	59.1	43.2
Bizneset – përfitues indirekt	1. Bizneset e vlerësojnë shkollën si institucion me reputacion/ imazh të mirë.	81.4	100	100.0
Prindërit – përfitues indirekt	1. Prindërit e nxënësve të shkollës dhe nxënësve të	70.7	86.9	69.9

	klasave të 8-9 vlerësojnë shkollën si institucion me imazh të mirë.			

Gjurmimi në nivel ofruesi

Për vitet 2025-2026, krahasimi tregon një përmirësim të dukshëm në përdorimin e të dhënave të gjurmimit nga drejtuesit dhe mësuesit. Përdorimi i të dhënave për përmirësimin e procesit mësimor ka shënuar një rritje nga 68% në 2025 në 90% në 2026, duke treguar një angazhim më të madh në përdorimin e të dhënave për përmirësimin e mësimdhënies. Ndërkohë, përdorimi i të dhënave të gjurmimit nga shkolla për përmirësimin e aktivitetit vjetor ka mbetur i pandryshuar në 80%.

Tabela 8: Rezultatet për treguesit e gjurmimit në nivel ofruesi

Përfitues të shërbimit	Treguesit e cilësisë	Rezultati 2024 %	Rezultati 2025 %	Rezultati 2026 %
Drejtuesi dhe Mësuesit – përfitues direkt	1. Drejtuesit dhe mësuesit përdorin të dhënat e gjurmimit për të përmirësuar procesin mësimor dhe aktivitetet e lidhura me të.	77.8	68.0	90.0
	2. Shkolla i përdor të dhënat e gjurmimit për përmirësimin e aktivitetit vjetor	77.8	80.0	80.0

Rekomandime për forcimin institucional

Rekomandimet e mëposhtme lidhen drejtpërdrejt me gjetjet e këtij raporti. Për treguesit e mësuesve, ku baza e përgjigjeve është e vogël, hapi i parë i rekomanduar është të kuptohet situata para se të ndërmerren veprime.

1. Të kuptohet rënia e treguesve të mësuesve

Njësia e Zhvillimit të organizojë një takim reflektimi me stafin për ZHVP-në, mbështetjen për kurrikulën dhe projektet, dhe të synojë pjesëmarrjen e të gjithë mësuesve në ciklin e ardhshëm të vlerësimit.

> **Gjetja:** Në 2026 u përgjigjën 10 mësues (nga 25 në 2025). Përputhja e ZHVP-së me nevojat ra nga 80.0% në 60.0%, kënaqësia me mbështetjen gjatë zbatimit të planit të ZHVP-së nga 91.7% në 60.0% dhe me koordinatorin e kurrikulës nga 88.0% në 60.0%. Çdo mësues përfaqëson 10 p.p.

2. Organizimi i praktikës, jo vetëm shtrirja e saj

Pas çdo periudhe praktike të zhvillohet një bisedë vlerësuese me nxënësit, dhe planet e praktikës të harmonizohen me bizneset pritëse.

> **Gjetja:** 93.2% e nxënësve kryejnë praktikë në biznes dhe bizneset i vlerësojnë lart (97.0%), por kënaqësia e nxënësve me mundësitë e praktikës ra nga 89.9% në 77.4% dhe me realizimin sipas planit nga 89.9% në 74.1%.

3. Komunikim më i saktë me nxënësit dhe prindërit

Materialet informuese dhe komunikimi me prindërit të rishikohen, që informacioni për shkollën dhe profilet të jetë i saktë, i përditësuar dhe i kuptueshëm.

> **Gjetja:** Vlerësimi i cilësisë së informacionit ra nga 88.6% në 60.1% te nxënësit dhe nga 92.0% në 77.8% te mësuesit. Vlerësimi i prindërve për imazhin e shkollës ra nga 86.9% në 69.9%.

4. Projekte zhvillimore më të dukshme

Projektet në zbatim të prezantohen periodikisht para stafit dhe nxënësve, dhe grupet e punës për hartimin e projekteve të rihapen për mësuesit.

> **Gjetja:** Njohja e projekteve nga mësuesit ra nga 88.0% në 60.0% dhe përfshirja e tyre në hartim nga 60.0% në 30.0%. Përfshirja e nxënësve në projekte ra nga 79.4% në 70.1%.

5. Të dëgjohen bizneset për bashkëpunimin

Pas verifikimit të këtij treguesi, shkolla t'i pyesë drejtpërdrejt bizneset partnere se çfarë do ta bënte bashkëpunimin më të kënaqshëm.

> **Gjetja:** 37.5% e bizneseve janë të kënaqura me bashkëpunimin dhe 62.5% janë neutrale, ndërkohë që 94–100% e tyre japin vlerësime pozitive për të gjitha aspektet e tjera. Rezultati kërkon verifikim para interpretimit.

Shtojcat

Gjetjet nga pyetësorët, viti shkollor 2025-26



Shkolla Tregtare_Indeksi.xlsx